

PAKETA E SIGURIMIT TE HOTELEVE & STRUKTURAVE AKOMODUESE

Ndërtesa & pajisje Mbulim për ndërtesën, mobilimin, pajisjet kryesore & stokun.	Përgjegjësi ndaj palëve të treta Mbulim për dëme ndaj vizitorëve & palëve të treta.	Aksidente personale për stafin Mbulim për humbje jete aksidentale, paaftësi & shpenzime mjekësore.
---	---	--

Për kë është kjo paketë

E përshtatshme për të gjithë operatorët që operojnë në industrinë e turizmit me akomodim, Bare & Restorante, evente, pishinë/spa, parking ose shërbime shtesë për vizitorët:

- **Hotelet**
- **Boutique hotels**
- **Apart-hotele**
- **Guesthouses**
- **Resorte**
- **Vila turistike**
- **Struktura të tjera akomoduese**

Çfarë përfiton klienti

- Një paketë të vetme sigurimesh e cila kompletton nevojat e biznesit dhe ofron mbrotje financiare në rast dëmtimi të pronës dhe biznesit.
- Mbulim bazë për asetet, përgjegjësinë dhe stafin, me opsione zgjerimi sipas profilit të hotelit.
- Zgjidhje të përshtatshme si për struktura të vogla familjare, ashtu edhe për hotele me operim më kompleks.

Struktura komerciale e paketës së sigurimeve

Paketa	Bazë	Plus	Premium
E përshtatshme për	Boutique hotels, guesthouses, vila turistike	Hotele qyteti dhe struktura me Bare & Restorante	Resorte, hotele me pishinë/SPA dhe operim më kompleks
Mbulimi bazë	Pronë + Përgjegjësi + aksidente personale	Të gjitha mbulimet bazë + zgjerime kryesore	Të gjitha mbulimet bazë + zgjerimet prioritare
Mbulime shtesë	Vjedhje, dëme nga uji, Thyerje Xhamash	Ndërprerja e Biznesit; Helmim nga pija/ushqimi Sende personale të vizitorëve	Pishinë/SPA/gym, valet/garage, Kasaforta

Mbulimet bazë të rekomanduara

1. Sigurimi i pronës së hotelit

- Ndërtesa, ambientet ndihmëse dhe instalimet.
- Mobilimi, pajisjet e kuzhinës, lavanderisë dhe sistemet teknike.
- Inventari i nevojshëm për operim.
- Rreziqe tipike: FLEXA (zjarr, rrufe, shpërthim, rënie e avionëve dhe/ose pjesë prej tyre); Tërmet; Stuhi; Përmbytje; vjedhje me dhunë; dhe rreziqe të tjera sipas paketës.

2. Përgjegjësia ndaj palëve të treta

- Dëmtime trupore ose materiale ndaj vizitorëve apo furnitorëve.
- Mbulim për operimin e hotelit, zonat e përbashkëta, restorantin/barin dhe shërbimet ndihmëse.
- Kur ka Bare & Restorante, mund të përfshihet edhe Sigurimi i Përgjegjësisë së Produktit.

3. Aksidentet personale për stafin

- Ofron mbulim për humbje jetë aksidentale dhe paaftësi të përhershme.
- Mundësi për mbulim 24/7
- E përshtatshme për të gjithë stafin.

*Mbulime shtesë të përshtatura enkas për bizneset hoteliere

Opsione të rekomanduara

- Ndërprerje biznesi / humbje fitimi bruto
- Sendet personale të vizitorëve dhe para në kasafortë
- Përgjegjësi ndaj palëve të treta në rast të helmimit nga ushqimet e konsumura
- Akomodim alternativ për vizitorët

Opsione të rekomanduara

- Përgjegjësi për pishinë, Spa, palestër dhe aktivitete sportive
- Përgjegjësi për parkim, garazh
- Mbulim automatik për investime të reja
- Mbulim të rrezikut kibernetik dhe reputacional

Terma kryesorë që reflektohen në Policën e Sigurimit

- Shuma e siguruar për ndërtesën, mobilimin, pajisjet dhe stokun.
- Limiti për çdo ngjarje dhe limiti agregat vjetor për sigurimin e përgjegjësisë.
- Përfitimet për stafin për sigurimin nga aksidentet personale.
- Pjesët e zbritshme të aplikueshme në rast dëmi.
- Territori i mbulimit, kushtet e ruajtjes dhe përjashtimet standarde.

Informacioni minimal i nevojshëm për ofertim

Fusha	Çfarë kërkohet	Pse është e nevojshme
Profili i hotelit	Lloji i strukturës, nr. i dhomave, aktivitetet, sezonaliteti	Përcakton ekspozimin bazë dhe paketën e duhur
Asetet	Vlera e ndërtesës, mobilimeve, pajisjeve dhe stokut	Përcakton shumën e siguruar dhe riskun e pronës
Shërbime & struktura të tjera	Bare & Restorante, Pishinë/Spa, Evente, Parkim, sporte ujore, etj	Ndikon në sigurimin e përgjegjësisë dhe zgjerimet opsionale

Sa kushton kjo paketë

Cmimi i paketës varion dhe lidhet ngushtë me madhësinë e hotelit/strukturës akomoduese, vendndodhjes, cilësisë së ndërtimit, larminë e shërbimeve të ofruara, etj

Merrni nje oferte : [Contact form button](#)